



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

Nr. 128 Prot.

Tiranë më 20/06 /2018

Proces-verbal

Mbledhja e Bordit Mbikqyrës të AMSHC-së

Sot, në datën 20.06.2018 në orën 17:00, në ambientet e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) u mbajt mbledhja e radhës e Bordit Mbikqyrës të AMSHC-së.

Rendi i ditës, sipas njoftimit paraprak të kryetares së Bordit Mbikqyrës ishte:

1. Diskutim dhe informim në lidhje me sa dhe si janë zgjidhur ankesat e bëra nga Organizatat e ndryshme në lidhje me mos kualifikimin e projekteve të tyre si fitues në thirrjen nr. 11
2. Diskutimi rreth mundësisë për shpalljen e një thirrje tjetër për projekt-propozime.

Në mbledhje të pranishëm ishin Drejtori Ekzekutiv i AMShC- së dhe anëtarët si më poshtë:

1. Z. Adrian THANO
2. Z. Aldo MERKOCI
3. Z. Ismail ADEMI
4. Znj. Kozara KATI
5. Z. Oltjon MUZAKA

Znj. Kati deklaroi të hapur mbledhjen duke prezantuar rendin e ditës dhe më pas fjalën e mërt Drejtori Ekzekutiv, z. A Kananaj .

Lidhur me pikën e parë të rendit të ditës, z. Kananaj deklaroi se ka pasur shumë ankesa nga organizatat dhe si janë zgjidhur ato ai shprehet se ankesa ka pasur por jo shumë.

Kur ankesat janë zgjidhur duke u dërguar letër sqaruese Organizatave me të gjitha mangësitë të evidentuara gjatë vlerësimit të projekteve, gjë që dhe i ka skualifikuar ato.

Ai sqaron se kemi pasur dhe rast kur përfaqësues të organizatës kanë ardhur pranë zyrave tona dhe janë sqaruar edhe gojarisht për aresyen e moskualifikimit.

Z. Kati pyet a ka pasur konflikt me to?

Drejtori Ekzekutiv thotë se jo, nuk ka pasur konflikt. Gjithçka është zgjidhur si edhe u shpjegua me sipër. Organizatat kanë marrë përgjigje shkresore apo elektronike rast pas rasti.

Ne vijim të diskutimit nga anëtarët e pranishëm ngrihet problemi i dokumentacionit si rrjedhojë e kërkesave të vazhdueshme të OJF-ve për lehtësimin e procedurave të aplikimit por pasi sqarohen se cila është paketa e dokumentave që i bashkëngjiten formularit të aplikimit nga Z. Muzaka hidhet mendimi që ndodhja do ishte me e lehtë që një pjesë e dokumentacionit të nxirret online nga e-Albania.

Ne vijim të mbledhjes Z. Kati kërkon që në shtator të kemi informacion mbi ecurinë e projekteve të thirrjes 11 dhe me pas kalon tek pika 2 e rendit të ditës „Shpallja e thirrjes 12.

Ajo kërkon nga Drejtori Ekzekutiv një situacion financiar se ku jemi? Ç'fare është dhënë e ç'fare ka mbetur? Deri kur shkon shtrirja e projekteve që janë duke u implementuar etj.

Drejtori Ekzekutiv jep sqarimet e nevojshme dhe shton se shuma e ngelur nuk është e madhe por kemi bërë kërkesë për fonde shtesë. Besojmë se shumë shpejt do i kemi ato.

Z. Ademi thekson se duhet pasur kujdes që të mos prekim shumë fondin e ardhshëm pasi ai mund të zvogëlohet me 30% të buxhetit.

Ne përfundim të mbledhjes të pranishmit bien dakort që të pritët nëse do të miratohet fondi shtesë i kërkuar dhe në varësi të kësaj, propozohet që mbledhja e radhës të realizohet në vazhdim me qëllim shpalljen e thirrjes nr.12.

Mbledhja deklarohet e mbyllur në orën 18:30.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE

Kozara KATI

Kryetare e Bordit Mbikqyrës

Majlinda DHUKA

Nënkryetare e Bordit Mbikqyrës

Alban DUDUSHI

Anëtar

Oltjon Muzaka

Anëtar

Aldo MERKOCI

Anëtar

Endri FUGA

Anëtar

Gelardina PRODANI

Anëtare

Ismail ADEMI

Anëtar

Adrian THANO

Anëtar